

Mirësevini në Mbretërinë e Bashkuar

Videot udhezojne për jetën në Mbretërinë e Bashkuar për Refugjatët dhe Azilkërkuesit dhe të tjerët të rinj në Mbretërinë e Bashkuar.


Mbërritja në një vend të ri paraqet shumë sfida dhe njerëzit duhet të përshtaten shpejt me sistemet, ligjet, normat shoqërore, pritjet, të drejtat dhe përgjegjësitë e panjohura.

Informacioni është mbledhur nga njerëz që janë rrefugjate ose azilkerkues për t'ju informuar.

Shikoni videos në:

www.nemp.org.uk/resources/

[Regional Refugee Forum North East - YouTube](#)



Prindërimi në Mbretërinë e Bashkuar

Kujdesi për shëndetin tuaj

Ligjet & Jeta në Mbretërinë e Bashkuar

Këto video janë pjesë e Programit të Mirësearchjes dhe Induksionit (vënies në post) të Partneritetit të Migracionit të Veriut Lindor për Refugjatët dhe Azilkerkuesit që sapo vijnë dhe janë bërë në partneritet me Forumin Rajonal të Refugjatëve Veri Lindje anëtarët e të cilit kanë përkthyer videot në gjuhët e tyre. Faleminderit anëtares të RRF Riada Kullani të RCO Diversity Inside Us për perkthimin e versioneve në shqip.



Prindërimi në Mbretërinë e Bashkuar

Arritja në një vend të ri paraqet shumë sfida për prindërit. Ju duhet të përshtateni menjëherë me sistemet, ligjet, normat shoqërore, pritjet, të drejtat dhe përgjegjësitë e panjohura. Kjo video shpjegon sistemin arsimor të Mbretërisë së Bashkuar, atë që mund të prisni nga shkollat dhe atë që shkollat u kërkojnë prindërve të bëjnë. Gjithashtu shpjegon ligjet dhe pritjet e Mbretërisë së Bashkuar për t'i mbajtur fëmijët të sigurt nga dëmtimet fizike dhe emocionale. Kjo është me të vërtetë e rëndësishme për mënyrën se si ju mbikëqyrni dhe disiplinoni fëmijët tuaj këtu. Informacioni zgjidhet nga prindërit të cilët e kanë jetuar këtë sfidë. Kjo është e bazuar në atë çka ata dëshironin të kenë ditur kur mbërritën për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar. Ata shpresojnë se kjo do ju ndihmojë dhe të mbështesni fëmijët tuaj dhe të parandaloni problemet që lindin.

Shikoni video në:

www.youtube.com/watch?v=MpedbB4gy0s

www.nemp.org.uk/resources/

Ju mund të shkarkoni dhe të printoni fletëpalosje që përmbledhin këtë informacion në:

www.nemp.org.uk/parenting-in-the-uk-leaflets/

dorë www.nemp.org.uk/education-in-the-uk-leaflets/

Përmbajtja:

- Roli i agjencive të ndryshme në mbajtjen e fëmijëve të sigurt nga dëmtimi dhe fuqia e tyre për të ndërhyrë.
- Mbështetja para se fëmija juaj të jetë 5.
- Edukimi për moshat 5 deri 11 vjeç: Shkolla fillore.
- Ligji për ndjekjen e shkollë.
- Arsimi për moshat 11 deri 16 vjeç: Tete-vjecare, Shkolla e mesme.
- Edukimi dhe trajnimi 16-18 vjeç.
- Edukimi dhe trajnimi pas 18 vjeç duke përfshirë Bursat e Sanctuary.
- Mbrojtja e fëmijës tuaj nga ngacmimi, urrejtja dhe abuzimi në internet.
- Si ta ndihmoni fëmijën tuaj të qëndrojë brenda ligjeve për alkoolin, drogën, duhanin dhe seksin.
- Si të menaxhoni pritjet kur fëmija flen tek një shoqe apo shoqe.
- Mbikëqyrja e fëmijëve në shtëpi dhe jashtë saj.
- Ligji për fëmijët dhe makinat.
- Ligji për mënyrën e disiplinimit të fëmijëve.
- Format alternative të disiplinimit të fëmijëve që nuk përdorin ndëshkim fizik.
- Si mund të ndikojë tek një fëmijë dhuna ose abuzimi midis prindërve?
- Ligji për gjymtimin / rrethprerjen e organeve gjenitale të femrave.
- Zëri i fëmijës.
- Të drejtat e prindërve.



Kujdesi për shëndetin tuaj

Kjo video shpjegon se si dhe kur duhet të keni qasje në kujdesin shëndetësor nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Mbreterise se Bashkuar ('NHS') dhe udhëzimet për vetë-kujdesin dhe jetesën e shëndetshme.

Shikoni video në:

www.youtube.com/watch?v=QOrw7GHZzo

www.nemp.org.uk/resources/

Ju mund të shkarkoni dhe të printoni një fletëpalosje që përmbledh këtë informacion në:

www.nemp.org.uk/looking-after-your-health-leaflets/

Përmbajtja:

- Si të regjistrohesh te një mjek, të rezervoni një takim, të kërkonit një përkthyes dhe të përdorni shërbime të tjera të specializuara shëndetësore përmes një mjeku.
- Kur dhe si të përdorim vetë-kujdesin, linja telefonike NHS 111, farmacistët, mjeku, aksidenti dhe urgjenca dhe linja telefonike e shërbimeve të urgjencës 999.
- Si tregojnë certifikatat HC1 dhe HC2 që ju keni të drejtë për kujdes shëndetësor falas.
- Si të merrni ilaçet dhe të kuptoni recetat.
- Shëndeti i fëmijëve.
- Kujdesi për sytë dhe kujdesi për dhëmbët.
- Programet e shqyrtimit shëndetësor.
- Kontracesioni dhe shëndeti seksual.
- Mbajtja e një koke të lumtur(tru të shëndetshëm) '(veçanërisht e rëndësishme për njerëzit që merren me përvoja traumatike dhe ankth të vazhdueshëm).
- Jetë e shëndetshme: dietë dhe ushtrime fizike.



Ligjet & Jeta në Mbretërinë e Bashkuar

Kjo video shpjegon rolin e policisë në Mbreterine e Bashkuar dhe disa ligje dhe pritshmëri kryesore rreth jetës në komunitet. Shpresojmë që t'ju ndihmojë të stabilizoheni në komunitet dhe të kërkonti ndihmë dhe këshilla kur keni nevojë për të.

Shikoni video në:

www.youtube.com/watch?v=nmqv4kYxnnM

www.nemp.org.uk/resources/

Ju mund të shkarkoni dhe të printoni një broshurë që përmbledh këtë informacion në: www.nemp.org.uk/laws-and-life-in-the-uk-leaflets/

Përmbajtja:

- Roli i shërbimit policor.
- Vlerat, përgjegjësitë, të drejtat dhe liritë.
- Ndërveprimi me të tjerët.
- Në shtëpi.
- Në punë.
- Ngarjen e makines.
- Alkooli, duhani dhe ilaçet.
- Nëse përjetoni agresion.
- Kur policia mund të ju 'ndalojë dhe t'ju kontrolloj'.
- Ligjet mbi seksin, dhunën në familje, rrethprerjen e grave, dhunën e bazuar në nder dhe martesën e detyruar.
- Mbrojtja dhe kujdesi për fëmijët tuaj.
- Si të bëni një ankesë në lidhje me policinë.
- Si të kontaktoni policinë në internet, personalisht, përmes telefonit dhe në rast urgjence.